

Në bazë të nenit 15, të Ligjit për Planifikim Hapësinor, nr. 2003/14, nenit 12, alineja 1 dhe 2 dhe të nenit 17, alineja 1, pika b të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale, nenit 25, alineja 4 pika (b) dhe të nenit 27, alineja 1 të Statutit të Kuvendit të Komunës së Prizrenit, Kuvendi i Komunës, në mbledhjen e vet të mbajtur më 20 maj 2011, miratoi këtë:

## V E N D I M

Për miratimin e Planit Rregullues Urban për lokacionin "Qendra e Re - 2" të qytetit të Prizrenit (konteksti i gjerë hapësinorë)

### Neni 1

Me këtë Vendim bëhet miratimi i Planit Rregullues Urban për lokacionin "Qendra e Re-2" të qytetit të Prizrenit (konteksti i gjerë hapësinorë), investitor i së cilës është KK Prizren, ndërkaq e njëjta është e hartuar nga ana e byrosë projektuese Sh.P.K. "Rafii" nga Prishtina (hartues i Planit Rregullues Urban) në të cilën lokacion është paraparë ndërtimi mikst (Qendër Administrative) në pajtim me Planin Zhvillimor Urban të qytetit të Prizrenit.

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi të PRRU-së do të jetë elaborati me të gjitha shtojcat grafike dhe tekstuale.

Pjesa tekstuale përmban:

- Kushtet për rregullimin dhe destinimin e ndërtimeve në këtë hapësirë.

Pjesa grafike duhet të përbajë:

- Paraqitjen grafike të Planit Rregullues Urban.

### Neni 2

Plani Rregullues Urban për "Qendrën e Re - 2" (konteksti i gjerë hapësinorë), përfshinë lokacionin në vijim: Anën e djathtë të rrugës Prizren – Zhur duke filluar prej Gjykatës deri te tregu i plaçkave në lagjen "Bajram Curri", që kufizohet në Jugë me rrugën "Wiliam Woker"#, në Lindje me rr. "De Rada", në veri me rr. "Zara" si dhe shiritin gjelbërues të rrugës që ndan Zonën Industriale, dhe përfshinë një sipërfaqe prej 33.60 ha.

### Neni 3

Me Planin nga neni 1 i këtij Vendimi është planifikuar zgjidhja e hapësirës në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale për zhvillimin e ardhshëm të Prizrenit, me qëllim që t'ju mundësojë qytetarëve jetën në një qytet me planifikim dhe kushte të sigurta të investimit.

Neni 4

Ky Vendim bashkë me dokumentacionin e përshkruar në nenin 1 alineja 2. të këtij Vendimi do të jetë pjesë përbërëse e Planit Zhvillimor Urban të qytetit të Prizreni.

Neni 5

Plani Rregullues Urban është hartuar për periudhën kohore më së paku 5 (pesë) vjeçare.

Neni 6

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdesen: Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor.

Neni 7

Ky Vendim hyn në fuqi që nga dita e miratimit dhe i njëjti do të shpallet në "Kumtar".

**KOMUNA E PRIZRENIT**  
**Kuvendi i Komunës së Prizrenit**  
**Nr: 01/011-5300**  
**Më 20 maj 2011**  
**Prizren**



**Kryesuesi i Kuvendit**  
**Nijazi Kryeziu**